



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FIER

Nr. 8111 Prot.

Fier, më 23.01.2026

PROJEKT – VENDIM

Nr. 06, datë 23.01 2026

**“Për dhënie pëlqimi për pranimin e donacionit nga subjekti “2FAF” shpk Fier me NUIS K12607402Q, në cilësinë e donatorit, për investim dhe zbatim të projektit me objekt: “Ndërtim i një kompleksi rekreativ, i përbërë nga 2 minifusha dhe një kënd lojrash”, në Njësinë Administrative Portëz, me përfitues Bashkinë Fier”**

Në mbështetje të neneve 3, 9, pika 1.6, shkronja “a”, 18, *gërma e, pika 1, neni 54*, pika ‘k, 55 dhe 64 të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, në Ligjin nr.7892 datë 21.12.1994 “Për Sponsorizimet” i ndryshuar, në Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, në Ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, në Ligjin Nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, në Udhëzim nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; në VKM nr.901 datë 21.12.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Portëz, të Qarkut të Fier”, bazuar në kërkesën për sponsorizim nga subjekti “2FAF” shpk me NUIS K12607402Q, protokolluar në Bashkinë Fier me nr.420 prot, datë 14.01.2026, Kryetari i Bashkisë Fier,

**PROPOZON:**

1. Për dhënien e pëlqimit për pranimin e donacionit nga subjekti “2FAF” shpk Fier me NUIS K12607402Q, në cilësinë e donatorit, për projektim, investim dhe zbatim të projektit me objekt: “Ndërtim i një kompleksi rekreativ, i përbërë nga 2 minifusha dhe një kënd lojrash”, në Njësinë Administrative Portëz, me përfitues Bashkinë Fier.
2. Vlera e donacionit , si investim në natyrë , regjistrohet si aset i Bashkisë Fier, pas kryerjes së investimit dhe marrjes së tij në dorëzim.

3. Të autorizohet Kryetari I Bashkisë Fier t ose personi I autorizuar prej tij të nënshkruajë kontratën e sponsorizimit dhe ndjekjen e procedurave vijuese ligjore, në funksion të realizimit të këtij projekti;
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe ekzekutivi i Bashkisë Fier.

**Drejtoria e Planifikimit te Territorit**

Florjan Troka

**Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit e Pronave**

Erdiola Dhanili

**Drejtoria e Financë Buxhet e Kontabilitet**

Pranvera Çina

**Drejtoria Juridike**

Esmeralda Kapllanaj

**KRYETARI**  
**Armando Subashi**

